

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit për kontrollin e veprimtarisë ekonomike të institucioneve qendrore e vendore që përdorin fonde publike;

- Duke vlerësuar kontributin e tij për përmirësimin e administrimit të fondeve publike;

- Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut, në përgjithësi, informacionin e nevojshëm për administrimin e fondeve publike;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare të fushës së kontrollit ekonomik e financiar;

Konstaton se gjatë vitit 2009 Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në Kushtetutë, ligjin organik për Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe planin e zhvillimit strategjik për periudhën 2009-2012;

- Ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me standardet e kontrollit, rregulloren e brendshme, manualin, si dhe dokumentet e tjera të institucionit;

- Ka përmirësuar dhe plotësuar metodologjinë e kontrollit, mbështetur në standardet e kontrollit të INTOSAI-t dhe produktet e projektit të bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve partnere;

- Ka përmirësuar cilësinë e veprimtarisë kontrolluese, nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të kontrollit të performancës;

- Ka rritur efektivitetin e veprimtarisë së tij, nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë dhe rritjes profesionale të stafit kontrollues; ka rritur forcën zbuluese të kontrollit, si dhe ka rekomanduar zhvendëtimin dhe arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar;

- Ka rekomanduar marrjen e masave me karakter organizativ, administrativ e ligjor për rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike, si dhe ka ushtruar kontroll për zbatimin e tyre nga drejtuesit e institucioneve të ndryshme;

- Ka përdorur me efektivitet fondet buxhetore të institucionit, duke reduktuar shpenzimet për veprimtarinë kontrolluese;

- Ka rritur bashkëpunimin me organet e kontrollit të brendshëm në drejtim të programimit të subjekteve e të tematikave të kontrollit;

- Ka dhënë kontribut, nëpërmjet rekomandimeve, për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore;

- Ka informuar periodikisht institucionet e përcaktuara me ligj dhe publikun për rezultatet e veprimtarisë së tij kontrolluese.

Kuvendi kërkon që për vitin 2010 Kontrolli i Lartë i Shtetit të thellojë më tej përvojën në drejtimet e mëposhtme:

- Rritjen e pavarësisë së institucionit dhe organizimin e kontrolleve me cilësi, efektivitet të lartë, objektivitet e profesionalizëm;

- Përdorimin gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore në kontroll, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira në fuqi; përqendrimin e kontrollit në subjektet me rëndësi të veçantë për ekonominë, të cilat menaxhojnë vlera të mëdha materiale dhe financiare në qeverisjen qendrore dhe vendore;

- Rritjen e cilësisë dhe të performancës gjatë kontrollit për përdorimin e kapitalit dhe të fondeve të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare;

- Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin, në mënyrë të veçantë me Komisionin për Ekonominë dhe Financat, me Këshillin e Ministrave dhe institucionet qendrore, për përmirësimin

e legjislacionit dhe administrimin e vlerave materiale e monetare; fuqizimin e bashkëpunimit me organet e drejtësisë, për të vënë para përgjegjësisë shkelësit e ligjit;

- Rritjen e nivelit profesional të stafit, veçanërisht të atij kontrollues;
- Forcimin e bashkëpunimit me strukturat e auditit të brendshëm, si dhe harmonizimin e veprimtarisë me to.

Kuvendi përcakton si objektiva të tij, në raport me Kontrollin e Lartë të Shtetit:

- Forcimin e bashkëpunimit me këtë institucion, për përmirësimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit;

- Sigurimin e mbështetjes ndaj institucionit, për t'i krijuar atij të gjitha kushtet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë;

- Realizimin e detyrimit ligjor për auditimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të institucionit;

- Bashkëpunimin më të mirë dhe me efektivitet të Prokurorisë me Kontrollin e Lartë të Shtetit për administrimin dhe përdorimin e fondeve publike.

22 prill 2010